



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

10987
Nr. ___ Prot

Divjakë, më 17/10/2025

LËNDA: PROJEKT PËR KONSULTIM PUBLIK

“MBI DISKUTIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, që përcakton parimet e përgjithshme dhe organizimin e funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri;

Në përputhje me Ligjin nr.9936 datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili rregullon menaxhimin e burimeve financiare publike dhe procesin e hartimit të buxhetit në nivel lokal dhe qendror;

Në vijim të Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i cili garanton autonominë financiare të njësive vendore, si dhe përcaktion mekanizmat e ndarjes së burimeve financiare nga niveli qendror drejt atij vendor;

Referuar Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i cili rregullon metodologjinë dhe hapat e detajuar për hartimin e planifikimit buxhetor afatmesëm;

Në përputhje me Kuadrin Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2026-2028, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.83, datë 05.02.2025, i cili përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028;

Si edhe duke marrë parasysh Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”, Udhëzimit Plotësues nr.19, datë 10.07.2025, të Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”.

Ligjit nr. 9970 dt.24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 dt.18.07.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”.

Udhëzimit Plotësues të Kryetarit të Bashkisë Divjakë nr.261 datë 28.07.2025 “Për përgatitjen e PBA 2026-2028 dhe Buxhetin e Vitit 2026 në Bashkinë Divjakë”, kemi përgatitur dokumentin paraprak të Projekt-Buxhetit për Vitin 2026 për konsultime publike.

Përshkrimi mbi Konsultimet Publike për Projekt-Buxhetin e Vitit 2026:

Konsultimet publike për projekt-buxhetin e Bashkisë Divjakë për vitin 2026 synojnë përfshirjen e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile, përfaqësuesve të biznesit, komuniteteve lokale dhe qytetarëve të interesuar në procesin e hartimit të buxhetit. Ky proces ka për qëllim rritjen e



transparencës dhe llogaridhënies nga Bashkia Divjakë dhe krijimin e mundësive për komunitetin që të japë kontributin e tij në identifikimin e prioriteteve buxhetore.

Diskutimet publike fokusohen në fushat kryesore të investimeve kapitale, rritjen e të ardhurave vendore, zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Gjatë këtyre takimeve Bashkia Divjakë paraqet parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimet për vitin buxhetor 2026, si dhe programet prioritare për zhvillimin e komunitetit.

Në përputhje me nivelin paraprak të parashikuar për burimet buxhetore për vitin 2026, Bashkia Divjakë ka bërë një përllogaritje të kujdesshme të të ardhurave të saj të mundshme, bazuar në të dhënat e viteve të mëparshme dhe në rregullat fiskale përkohëse. Më poshtë paraqitet pasqyra e përmbajtjes së dhënë për burimet buxhetore, me shtesë të detajeve shpjeguese dhe ndërlidhje me strategjinë e menaxhimit financiar (Shifrat janë të paraqitura në 000/ lekë):

Burimet Buxhetore/Financimit për vitin 2026 (në lekë)	
Trashëgimi nga viti i kaluar	61,701,644
Të Ardhura nga Burimet e Veta	211,864,000
Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme	307,633,973
Niveli i rritjes sw pagave T.P	41,043,007
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	167,078,102
Totali (Grupi 00)	789,320,726
Projekti Joinable, Financim i huaj me kapitull 02	3,851,578
Totali (Grupi 00) dhe projektin Joinable(Kapitulli 02)	793,172,304

-Trashëgimi nga viti i kaluar: Trashëgimi financiare nga viti 2025 parashikohet të jetë rreth 61,702 mijë lekë. Ky nivel konsiderohet mesatar në raport me vitet e mëparshme, duke u mbështetur në performancën financiare të Bashkisë Divjakë. Megjithatë, kjo vlerë është ende paraprake dhe mund të ndryshojë në buxhetin përfundimtar të vitit 2026, pasi të bëhet bilanci i saktë i të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2025. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit po vijon vlerësimet për të siguruar që trashëgimia financiare të reflektojë me saktësi realitetin ekonomik të bashkisë.

-Të Ardhura Vendore: Të ardhurat vendore për vitin 2026 janë përllogaritur nga Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore. Vlera totale e pritshme është 211,864 mijë lekë, ku përfshihen burimet e taksave të ndara dhe të ardhurat e tjera që gjenerohen nga aktivitetet vendore. Në dokumentin e Raportit PBA2 janë përfshirë dy pika kryesore që detajojnë zërat e ardhurave:

Pika 1 “Të ardhura nga burimet e veta” përllogaritur në 180,664 mijë lekë, ku përfshihen taksat dhe tarifat që mbledhen drejtpërdrejt nga Bashkia.

Pika 3 “Të ardhura nga taksat e ndara” në vlerën 31,200 mijë lekë, që përfshin pjesën e taksave që i ndahen bashkisë nga niveli qendror, siç janë taksat mbi pasurinë ose të ardhurat personale. Përllogaritja e këtyre të ardhurave bazohet në një analizë të kujdesshme të historikut të mbledhjes së taksave, rritjes ekonomike dhe kontributit të sektorëve kryesorë në ekonominë lokale.

Për detajim e pikës 1 dhe pikës 3 është tabela e mëposhtëme.

	Burimet Buxhetore	2026 Plani (në 000/lekë)
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	180,664
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	57,598
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	17,000
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	39,818
1.1.3	Taksa mbi truallin	340
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	440
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	13,500
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	13,500
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	2,880
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	2,100
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	390
1.3.3	Taksa e tabelës	390
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0
1.4	TARIFA VENDORE	91,186
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	32,621
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	5,000
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	8,165
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	2,300
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	2,000
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	2,500
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	100
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	11,900
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	1,500
1.4.11	Tarifa e parkimit	0
1.4.12	Tarifa të tjera	25,100
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	15,500
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	7,000



1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0
1.5.5	Shitja e asetëve financiare	0
1.5.6	Shitja e asetëve fikse të prekshme / paprekshme	8,500
1.5.7	Të tjera	0
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	0
1.6.1	Kamatëvonesat	0
1.6.2	Gjoha, sekuestrime dhe zhvëndime	0
1.6.3	Të tjera	0
3	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	31,200
3.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	19,200
3.2	Renta minerare	0
3.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	12,000
3.4	Të tjera	0

-Transferata e Pakushtëzuar e Përgjithshme: Transferata e Pakushtëzuar e Përgjithshme për Bashkinë Divjakë pritet të arrijë në 307,634 mijë lekë. Ky fond është pjesë e alokimeve qendrore për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe përdoret për mbulimin e shpenzimeve të zakonshme dhe për përmirësimin e infrastrukturës bazë. Kjo transferatë i jep bashkisë një fleksibilitet të konsiderueshëm në planifikimin e shpenzimeve dhe mund të përdoret për një sërë projektesh në varësi të nevojave të komunitetit lokal. Ndarja e transferatës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2026-2028, paraqitet në Shtojcën 1 “Parashikimi i transferatës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2026-2028, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 28.02.2025.

-Transferata e Pakushtëzuar Sektoriale: Kjo transferatë, e parashikuar në vlerën 167,078 mijë lekë, është e lidhur me mbështetjen financiare për sektorë specifikë të zhvillimit ekonomik dhe social në nivel lokal. Në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 28.02.2025 pika 83 "Ndarja e transferatës së pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2026-2028 do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transferatës së miratuar me buxhetin e vitit 2025" "Rritja e nivelit të pagave për transferatën sektoriale të paraqitur në Shtojcën 1 të Udhëzimit". Fondet e pakushtëzuara sektoriale mund të përdoren për përmirësimin e shërbimeve publike, edukimin, shëndetësinë dhe investimet në infrastrukturën rrugore apo sistemet e furnizimit me ujë. Qëllimi i kësaj transference është që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe adresimi i nevojave të sektorëve kyç në Bashki.

Konkluzioni: Bashkia Divjakë po ndjek një qasje të kujdeshme dhe të bazuar në të dhëna për përlllogaritjen e të ardhurave të saj buxhetore për vitin 2026. Përdorimi efektiv i këtyre burimeve do të mbështesë realizimin e objektivave të saj strategjike në ofrimin e shërbimeve publike, përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e komunitetit.

Shpenzimet për vitin buxhetor 2026, si dhe programet prioritare për zhvillimin e komunitetit.

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	PLANI 2026
	Shpenzime Personeli (600-601)	451,140
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	386,741
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	64,399
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	217,465
602	Mallra dhe sherbime te tjera	196,763
603	Subvencionet	0
604	Transferime korrente te brendeshme	20,702
605	Transferimet korrente jashte	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0
609	Rezervat	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	124,567
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	124,567
232	Shpenzime transferimet kapitale	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0
	TOTALI	793,172

Shpenzimet e Bashkisë Divjakë për vitin buxhetor 2026 janë të strukturuar në disa kategori kryesore, të cilat mbulojnë nevoja të ndryshme të menaxhimit të personelit, shërbimeve dhe investimeve kapitale. Më poshtë gjendet një përshkrim më i detajuar i shpenzimeve, bazuar në llogaritë dhe planifikimin e tyre për vitin 2026:

-Shpenzime Personeli (600-601): Totali i parashikuar për 2026 është 451,140 mijë lekë ku bëjnë pjesë (Paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera personeli (600) në 386,741 mijë lekë. Kjo kategori përfshin pagat dhe shpërblimet për punonjësit e administratës vendore dhe personelin tjetër që është i përfshirë në ofrimin e shërbimeve publike.) dhe (Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601) në 64,399 mijë lekë. Këto shpenzime mbulojnë kontributet e detyrueshme që paguhet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë punonjësit.).

-Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651): Totali i parashikuar për 2026 është 217,465 mijë lekë ku bëjnë pjesë (Mallra dhe shërbime të tjera (602) në 196,763 mijë lekë. Kjo shumë

përfshin shpenzimet për mallra dhe shërbime të nevojshme për funksionimin e administratës dhe ofrimin e shërbimeve për komunitetin. Kjo përfshin blerjen e materialeve zyrtare, mirëmbajtjen e infrastrukturës, si dhe shërbimet e kontraktuara.).

Shembuj të zërave që zenë peshë më të madhe janë:

1.Karburanti në vlerë 41,946 mijë lekë.

2.Energji, ujë, internet,Qira, shërbim postar në vlerë 30,974 mijë lekë.

4.Pjesa e mbetur janë mallra, shërbime të tjera, etj.

(Transferime korrente të brendshme (604) në 20,702 mijë lekë. Transferimet e brendshme përfshijnë fondet e alokuara për mbështetjen e njërive të tjera brenda administratës së bashkisë.) dhe (Subvencionet, transferimet jashtë, rezervat dhe interesat për huamarrje (603, 605, 609, 651) në 0 mijë lekë. Për vitin 2026, nuk janë parashikuar shpenzime për këto zëra.

-Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661): Totali i parashikuar për 2026 është 124,567 mijë lekë ku bëjnë pjesë (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (231) në 124,567 mijë lekë. Këto investime janë të fokusuara në përmirësimin dhe zgjerimin e aseteve kapitale të bashkisë, si infrastrukturë rrugore, ndërtesa publike, parqe dhe zona të tjera të rëndësishme për zhvillimin lokal.), dhe (Shpenzime të tjera kapitale të brendshme (230, 232, 255, 1661) në 0 mijë lekë. Këtu përfshihen zërat për asete të patrupëzuara dhe transferime kapitale, të cilat nuk janë planifikuar për këtë vit.)

-Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232): Totali i parashikuar për 2026 është 0 mijë lekë. Në buxhetin e vitit 2026 nuk janë parashikuar investime kapitale të financuara nga burime të huaja në fillim të vitit kalendarik.

Totali i Shpenzimeve për vitin 2026 është 793,172 mijë lekë. Programet Prioritare për Zhvillimin e Komunitetit, Bashkia Divjake për vitin 2026 synon të fokusohet në programet prioritare që do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët. Këto programe përfshijnë:

1.Zhvillimi i Infrastrukturës Lokale: Investimet në përmirësimin e rrugëve, sistemet e kanalizimeve dhe menaxhimin e mbetjeve, duke përmirësuar kushtet jetësore dhe mundësitë për zhvillim ekonomik.

2.Rritja e Kapaciteteve Publike: Investime në ndërtesa publike, shkolla dhe qendra shëndetësore(me financim edhe nga shoqata, ministri përkatëse, etj, gjatë vitit kalendarik) për të rritur aksesin në shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët.

3.Mbështetja për Zhvillimin Rural: Bashkia Divjake synon të mbështesë zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit rural për të gjeneruar vende pune dhe të ardhura për komunitetin.

4.Menaxhimi i Mjedisit dhe Përmirësimi i Hapësirave të Gjelbra: Projekte për mbrojtjen e zonave natyrore dhe përmirësimin e parqeve publike, duke ndikuar në cilësinë e jetës dhe promovimin e Divjakës si një destinacion ekologjik. Ky buxhet tregon një përkushtim për përdorimin efektiv të burimeve dhe investimin në projekte që kanë ndikim afatgjatë në zhvillimin ekonomik dhe social të Bashkisë Divjake.

Buxheti i Vitit 2026 i ndarë programe dhe llogari ekonomike për secilin program paraqitet në pasqyrwn e mwposhtwme:



EMËRTIMI I PROGRAMIT	2026					
	PERSONELI		KORRENTE TE TJERA		KAPITALE TE BRENDESHME	PLANI
	600	601	602	604	231	
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	176,452	29,234	111,560	0	20,730	337,976
03140 - Shërbimet e Policisë Vendore	7,431	1,241	253	0	0	8,925
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	14,800	2,472	5,121	0	0	22,393
04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik	8,933	1,492	3,749	0	0	14,174
04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	20,800	3,474	15,460	0	0	39,734
04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	578	97	425	0	0	1,100
04520 - Rrjeti Rrugor Rural	8,008	1,337	5,904	0	99,292	114,541
05100 - Menaxhimi i mbetjeve	1,359	272	17,819	0	0	19,451
06260 - Shërbimet Publike Vendore	71,600	11,958	21,234	0	1,620	106,412
06370 - Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	942	157	93	0	0	1,192
08130 - Sport dhe argëtim	2,980	498	1,200	0	0	4,677
08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat	7,607	1,270	4,487	0	0	13,365
09120 - Arsimit bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)	64,023	10,692	8,244	0	2,479	85,439
09230 - Arsimit i mesëm i përgjithshëm	1,228	205	213	0	447	2,092
10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	0	0	1,000	0	0	1,000
10661 - Strehimi social	0	0	0	0	0	0
04940 - Fondi Kontigjence	0	0	0	11,471	0	11,471
04910 - Fondi Rezerve	0	0	0	9,231	0	9,231
Totali	386,741	64,399	196,763	20,702	124,567	793,172

Projekte/Investime

Tabela e mëposhtme liston projektet dhe investimet për vitin 2025, që kanë likuidim të pjesshëm ose të plotë edhe në vitet e mëvonshme, përfshirë 2026, 2027, dhe 2028. Kjo tregon për projekte që janë në proces zbatimi dhe financimi që tejkalon një vit buxhetor, duke pasur nevojë për likuidim të fondeve në periudha më të gjata.

Projektet/investimet e vitit 2025 me likuidim edhe në vitet 2026, 2027, 2028: Këto janë projekte që kanë filluar në vitin 2025 dhe kërkojnë disbursime të mëtejshme financiare për zbatimin e tyre. Shpesh, këto janë projekte madhore të infrastrukturës apo zhvillimit urban që kërkojnë disa vite për t'u përfunduar dhe mund të përfshijnë rrugë, ndërtesa publike, ose projekte që lidhen me përmirësimin e shërbimeve komunale.

Projektet/investimet e vitit 2026, me ose pa likuidim në vitet 2027 dhe 2028: Projektet e planifikuara për të nisur në vitin 2026 mund të kenë likuidim të plotë brenda të njëjtit vit, ose mund të shtrihen në vitet e ardhshme (2026 dhe 2027) në varësi të kompleksitetit dhe madhësisë së tyre. Në këtë kategori hyjnë projekte të reja të identifikuara nga bashkia, të cilat janë pjesë e planifikimit afatmesëm buxhetor. Në të dyja rastet, është e rëndësishme të theksohet që bashkia planifikon likuidimin gradual të këtyre projekteve, duke siguruar që ato të përfundojnë brenda periudhës së caktuar, në përputhje me strategjitë e zhvillimit dhe financimin e alokuar për secilin vit të caktuar buxhetor. Gjithashti janë të listuara dhe projektet e investimeve të viteve 2027/2028 si edhe fondet në dispozicion për vitet 2027/2028.

KODI	EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT	KOSTO TOTAL E	2025 BUXHETI	2026 PLANI	2027 PLANI	2028 PLANI
P111-DJ-012	Ndricim ne rruget e territorit te Bashkise Divjake (1470173)(2147001)	12,000	7,000	5,000	0	0
P111-DJ-014	Blerje materiale per zyrat e Bashkise Divjake (1470175)(2147001)	5,957	1,000	1,967	2,990	0
P111-DJ-016	Investime per vitin 2027	9,189	0	0	9,189	0
P111-DJ-020	Blerje trailer per transport mbetjesh urbane. (1470185)(2147001)	8,000	2,500	3,763	1,737	0
P111-DJ-021	Blerje shtese impianti per trajtimin e ujrave te zeza Divjake dhe kanalizimiet perkatese. (1470186)(2147001)	18,292	18,292	0	0	0
P111-DJ-022	Blerje autobot uji per larjen e qytetit. (1470187)(2147001)	4,000	4,000	0	0	0
P111-DJ-023	Ndertim ndertesa e Njesise Administrative Gradishte.(1470188)(2147001)	10,000	10,000	0	0	0
P111-DJ-024	Ndricim ne rruget e territorit te Bashkise Divjake per vitin 2026.	10,000	0	5,000	5,000	0
P111-DJ-025	Blerje kosha metalik Xingato viti 2026.	5,000	0	5,000	0	0
P111-DJ-026	Blerje kosha metalik Xingato viti 2027.	5,000	0	0	5,000	0
P111-DJ-027	Blerje kosha metalik Xingato viti 2028.	5,000	0	0	0	5,000
P111-DJ-028	Investime per vitin 2028.	25,730	0	0	0	25,730
1470121	Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake. (1470121)(2147001)	59,504	35,504	24,000	0	0
1470122	Blerje çakell makinerie (1-100mm) per rruget urbane te Bashkise Divjake. (1470122)(2147001)	13,430	7,540	3,502	0	0
P452-DJ-009	Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake. (1470177)(2147001)	76,000	11,743	30,000	34,257	0



P452-DJ-011	Blerje cakell makinerie (sp1-100 mm) per rruge urbane dhe rurale ne Bashkine Divjake. (1470178)(2147001)	30,318	4,112	11,942	14,264	0
P452-DJ-017	Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake. Viti 2026.	50,000	0	19,848	15,152	15,000
P452-DJ-018	Blerje tuba te brinjezuar, KUB dhe KUZ, Bashkia Divjake. Viti 2026.	3,000	0	3,000	0	0
P452-DJ-019	Blerje cakell makinerie (sp1-100 mm) per rruge urbane dhe rurale ne Bashkine Divjake. Viti 2026.	18,000	0	7,000	5,000	6,000
P452-DJ-020	Investime per vitin 2027	31,619	0	0	31,619	0
P452-DJ-021	Investime per vitin 2028	83,978	0	0	0	83,978
P626-DJ-019	Investime per vitin 2026	1,620	0	1,620	0	0
P626-DJ-020	Investime per vitin 2027	1,620	0	0	1,620	0
P626-DJ-021	Investime per vitin 2028	1,620	0	0	0	1,620
P912-DJ-008	Blerje kamera sigurie per Kopshtin me dreke, Cerme Sektor.	1,000	0	1,000	0	0
P912-DJ-009	Investime per vitin 2026.	1,479	0	1,479	0	0
P912-DJ-010	Investime per vitin 2027	2,479	0	0	2,479	0
P912-DJ-011	Investime per vitin 2028	2,479	0	0	0	2,479
1470102	Mbikeqyrje punimesh: ndertim palestere te mbuluar dhe rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Cerme Sektor. (1470102/8140)(2147001)	1,181	735	447	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve				124,567	128,307	139,807

Në këto konsultime, qytetarët dhe grupet e interesit ftohen të japin komente dhe sugjerime mbi projektin e paraqitur, duke ndihmuar në identifikimin e sfidave kryesore me të cilat përballët bashkia, si dhe mundësitë për të përmirësuar shërbimet e ofruara për qytetarët. Përfundimet e konsultimeve pasqyrohen në dokumentin përfundimtar të buxhetit të vitit 2025, duke përfshirë ndryshime të mundshme në përputhje me komentet dhe sugjerimet e marra nga publiku.

Përgjegjës i Sektorit Juridik

Andi BULLARI

Përgjegjëse e Buxhetit dhe MFK

Irena GJONI

Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Ardit JANKO

Drejtor i Financës dhe Buxhetit

Xheladin BRAHKOLA

KRYETARI

Josif GORREA

Adresa: Pranë Sheshit "Santa Barbara", Divjakë

e-mail: info@bashkiadivjake.gov.al

